



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I TIRANËS
FAKULTETI I GJUHËVE TË HUAJA**



PROJEKTI FITUES ME TITULL:

“RËNDËSIA E INTELIGJENCËS ARTIFICIALE NË FORMIMIN AKADEMIK”

**FINANCUAR NGA MINISTRIA E ARSIMIT DHE SPORTIT
NË KUADËR TË NDËRKOMBËTARIZIMIT TË PROGRAMEVE TË STUDIMIT PËR
VITIN AKADEMIK 2022-2023**

Ekipi i projektit:

Prof. Asoc. Dr. Eglantina GISHTI (koordinatore)

Prof. Asoc. Dr. Alba FRASHËRI

Dr. Fjoralba DADO

Përshkrim i përgjithshëm i punës me aktivitetet e projektit në gjashtëmujorin e dytë

Qëllimi kryesor i i projektit është zhvillimi i diplomës së dyfishtë Master, i vetmi në këtë fushë i cili është i konceptuar mbi katër elemente bazë:

- 1) ndërdisiplinariteti, si nëndegë e Inteligjencës Artificiale, specifikisht Trajtimi Automatik i Gjuhëve kërkon kombinimin e shkencave kompjuterike dhe shkencave gjuhësore;
- 2) kërkimi shkencor, programet e studimit master në universitetet franceze janë të atashuara në laboratorë kërkimorë me qëllim përfshirjen e studentëve në projekte kërkimore;
- 3) baza të forta në njohuritë teorike në fushën përkatëse;
- 4) praktika e zhvilluar në institucione dhe kompani ndërkombëtare, sipas marrëveshjes midis dy institucioneve.

Projekti synon përfundimin e bashkëpunimit në disa dimensione: bashkëpunimi në fushën e kërkimit shkencor, shkëmbimi i njohurive, përmirësimi i tyre si dhe përvetësimi i kompetencave të reja lidhur me fushën e Inteligjencës Artificiale.

Objekti kryesor në fazën e dytë të projektit ishte finalizimi i programeve për diplomën e përbashkët dhe procedurat administrative të cilat kanë filluar në tetor 2021.

Në kuadër të ndërkombëtarizimit të institucionit, si një prioritetet i Qeverisë shqiptare dhe Universitetit të Tiranës, ofrimi i një programi studimi në bashkëpunim me një universitet francez prestigjioz siç është Sorbonne Paris Nord si dhe rëndësia e fushës në të cilën ofrohet, digjitalizmi, do t'u mundësojë studentëve shqiptarë të pajisen me një diplomë franceze dhe të specializohen në një fushë që kërkohet gjithmonë e më shumë.

Ky program masteri është i vetmi që ofrohet në IAL-të në Shqipëri.



Ky program synon që në këtë kuadër, të mundësojë një ofertë akademike dhe kërkimore nxitëse dhe konkurruese, që ofron mundësi për studentët e këtij programi të thellojnë dijet dhe kualifikohen më tej në fushën e digjitalizimit, përkatësisht të digjitalizimit gjuhësor.

Rëndësia e bashkëpunimit lidhet ngushtë edhe me ekspertizën dhe cilësinë e ofertës të institucionit francez: **masteri në Trajtimin informatik dhe gjuhësor të dokumenteve të shkruara.**

Diplomë e dyfishtë Master me Univesitetin Sorbonne Paris Nord

Fusha : Trajtimi Automatik i Gjuhëve

Drejtimi: Trajtimi Informatik dhe Gjuhësor i Dokumenteve të Shkruara

Ky program studimi synon :

- të familjarizojë studentët me Inteligjencën Artificiale,
- të dinë t'i mësojnë kompjuterit si të trajtojnë materialin gjuhësor duke e shndërruar këtë të fundit në të dhëna,
- t'u mësojë si të nxjerrin automatikisht kuptimin nga teksti, si të krijojnë chatbots, si të ndërtojnë rrjete neuronale (neural networks) apo si të përdorin të dhënat gjuhësore në sisteme informatike të dedikuara.

Studentët do të :

- pajisen me diplomë të dyfishtë nga Universiteti i Tiranës dhe Universiteti Sorbonne Paris Nord ;
- ndjekin studimet e vitit të dytë në Universitetin Sorbonne Paris Nord (nëse dëshirojnë),
- zhvillojnë praktikën në Francë, në ndërmarrjet me të cilat USPN ka marrëveshje.

www.fgjh.edu.al

Tashmë ky program ka marrë jetë dhe në vitin akademik 2023-2024 janë regjistruar 19 studentë (nga të cilët 10 shqiptarë dhe 9 të huaj) që janë duke ndjekur vitin e parë të studimit. Në vitin akademik 2022-2023 janë regjistruar 20 studentë (11 shqiptarë dhe 9 të huaj) të cilët aktualisht ndjekin vitin e dytë të programit në këtë master dhe do të diplomohen në vitin akademik 2023-2024.

Ata që do të përfundojnë me sukses këtë program studimi master, do të jenë në gjendje të modelojnë njohuritë e përfituara sipas nevojave të sektorit në të cilin do të punësohen si dhe do të përkufizojnë një temë kërkimore, të gjykojnë dhe analizojnë vlefshmërinë e burimeve teorike dhe praktike si dhe të ofrojnë zgjidhjen e problemeve konceptuale dhe praktike, të analizojnë sipas kontekstit të dhënat e përpunuara nëpërmjet digjitalizimit.

Hapja e programi të përbashkët të studimit Master në fushën e Trajtimit automatik të gjuhëve në UT, ofron një mundësi unike për të marrë një diplomë ndërkombëtare (e cila njihet në të gjitha vendet e Bashkimit Europian) për t'u rritur në karrierën profesionale, pasi për shkak të specifikave do të jetë i vetmi program studimi në UT i dedikuar dhe dizenuar në fushën e Trajtimit automatik të gjuhëve, të profilizuar, duke e bërë kështu një program që do kërkohe por dhe sfidues në tregun shqiptar të arsimit të lartë.

Për të realizuar të gjithë komponentet e këtij programi studimi, ekipi i projektit ka bashkëpunuar ngushtë me aktorë të jashtëm, institucione dhe ndërmarrje lokale dhe ndërkombëtare, të cilat e mbështesin masterin në forma të ndryshme, në stazhet e studentëve, punësimin e tyre, etj.

Përgatitja e procesit të hartimit dhe aplikimit të programit masterin TILDE, konsistoi në:

- Organizimin e takimeve të përfaqësuesve të universiteteve partnere;
- Përcaktimin e termave të referencës të projektit;
- Organizimin e formimeve dhe ditëve studimore;
- Përzgjedhjen e lektorëve lokalë;
- Përzgjedhjen e kandidatëve lektorë që do të ndjekin "në distancë" formimet që lidhen me Masterin TILDE, Sorbonne Paris Nord;

Drejtor i Masterit Prof. Pierre-André Buvet, mbikqur procedurat për regjistrimin e studentëve në Universitetin Sorbonne Paris Nord si dhe të studentëve francezë në Universitetin e Tiranës.

Duke patur parasysh aspektin ndërdisiplinor të këtij projekti, grupi i ekspertëve përbëhet nga profesorë nga USPN dhe UT (Fakulteti i Gjuhëve të Huaja dhe ai i Ekonomisë) të cilët do t'i mbulojnë të gjitha fushat e studimit të propozuara në masterin e dyfishtë.

Detyrat e anëtarëve të grupit të punës konsistojnë në: Promovimin dhe realizimin e diplomës së dyfishtë; Aplikimin/përzgjedhjen/regjistrimin e studentëve në UT; Përcaktimin e pedagogëve të cilët do të angazhohen në mësimdhënie dhe në përgatitjen e programit mësimor; Organizimin e takimeve të përfaqësuesve të universiteteve partnere; Përcaktimin e termave të referencës të projektit; Organizimin e formimeve dhe ditëve studimore; Përzgjedhjen e lektorëve lokalë; Përzgjedhja e kandidatëve lektorë që do të ndjekin "në distancë" formimet që lidhen me Masterin TILDE, Sorbonne Paris Nord; Finalizimi i programeve për diplomën e përbashkët dhe procedurat administrative.

Në datën 17 shkurt 2023, u zhvillua prezantimi i parë në radhën e leksioneve nga specialistë të trajtimit automatik të gjuhëve. Programi mësimor i diplomës së dyfishtë Master me universitetin Sorbonne, Paris Nord, Francë, në fushën e trajtimit automatik të gjuhëve parashikon cikël seminaresh nga specialistë të kësaj fushe, të cilët paraqesin projektet e tyre dhe situata reale nga tregu i punës. Xhensila Pode, përfaqësuese e kompanisë ndërkombëtare Cardo AI, prezantoi mundësitë e shumta të punësimit në këtë fushë, rëndësinë e trajtimit automatik të gjuhëve në krijimin dhe përmirësimin e Martit, chatbotit të tyre që ndihmon analistët e biznesit me menaxhimin e investimeve dhe huave.

Studentët panë për herë të parë një "ndalesë" të rrugës unike që i pret pas diplomimit!



Në datën 18 qershor 2023 Vizitë e delegacionit të Universitetit Sorbonne Paris Nord të përbërë nga Zv. Rektori i Marrëdhënieve me Jashtë, Prof. Guy Dirras dhe Koordinatorja e Aleancës Universitare UNINOVIS, Prof. Gladys Diaz, të shoqëruar nga pedagogia e Universitetit të Tiranës, Prof. As. Eglantina Gishti.

Gjithashtu grupi i ardhur nga Universiteti Sorbonne Paris Nord u shoqërua për një vizitë historike-kulturore në Muzeun Kombëtar të Përgjimeve "Shtëpia me Gjethe".



Gjatë vitit 2023 janë zhvilluar mobilitete ku studentë të Universitetit Sorbonne Paris Nord kanë kryer në Fakultetin e Gjuhëve të Huaja, dhe studente të Fakultetit e Gjuhëve të Huaja të regjistruar në diplomën e dyfishtë Master i Shkencave në fushën e Trajtimit Automatik të Gjuhëve në bashkëpunim me Universitetin Sorbonne Paris Nord, që aktualisht ndjekin vitin e dytë të studimeve në Paris.



Për referencë video në linkun: <https://fb.watch/pPn28T8NuY/>



Për reference informacion në linkun: <https://fgjh.edu.al/trajtimi-automatik-i-teksteve-te-shkruara/>

Promovimi në web i masterit:

Linku: <https://fgjh.edu.al/trajtimi-automatik-i-teksteve-te-shkruara/>

Linku: <https://fgjh.edu.al/njoftim-per-hapjen-e-aplikimeve-ne-programet-e-studimit-te-ciklit-te-dyte-me-kohe-te-plote/>

Promovimi i masterit të dyfishtë në një rubrikë të dedikuar TILDE

Linku: <https://fgjh.edu.al/tilde/>